

- 1. BPAL - “Rezonanca”**
- 2. Dega “Prishtinë”**
- 3. Aplikim për Akreditim:**
- 4. Bachelor në ‘Infermieri’**
- 5. Master në ‘Infermieri’**
- 6. Bachelor në ‘Biokimi laboratorike’**
- 7. Bachelor në ‘Mjekësi sanitare’**
- 8. Bachelor ‘Radiologji diagnostike’**
- 9. Master në ‘Radiologji diagnostike’**
- 10. Bachelor në ‘Farmaci komunitare’**
- 11. Master në ‘Farmaci’**
- 12. Bachelor në ‘Fizioterapi’**
- 13. Program i integruar (niveli 6 dhe 7) në Stomatologji**

Vlerësimi i institucionit:

BPAL- Rezonanca-Prishtinë është krijuar në vitin 2003 dhe i është bashkangjitur Kolegjit “Iliria” në vitin 2008. Për arsye strategjike, Rezonanca vendosi të ndahet nga Kolegji Iliria dhe të vazhdojë si një entitet i pavarur. Në të shkuarën, programet e studimit të Rezonancës organizoheshin nga Rezonanca dhe bashkëpunimi me Ilirinë ndihej vetëm në nivelin e menaxhimit. Sot Rezonanca ofron një program dinjitoz me të gjitha strukturat menaxheriale lokale të kërkuara, siç përshkruhet detajisht më poshtë. .

Parimi udhëheqës:

Parimi udhëheqës është në përputhje të plotë me programet e ndryshme të ofruara. Është vizioni i deklaruar që institucioni të jetë lider në sektorin arsimor të ofruar nga institucionet private që propozojnë programe në fushën e kujdesit shëndetësor. Nga diskutimet me ekipin e menaxhmentit, EE mësoi se shkolla po hyn në një fazë konsolidimi dhe ndërkombëtarizimi. Ky zhvillim është në përputhje me historinë e vonë të shkollës dhe është i akorduar me kapacitetet që shkolla ka kërkuar përgjatë viteve të fundit. Sa i përket infrastrukturës, një shtesë e rëndësishme është realizuar së fundmi, duke mundësuar rivendosjen e një numri thelbësor laboratorësh dhe sallash leksionesh në godinën e re. Shkolla planifikon të rimodelojë dhe të zmadhojë spitalin ekzistues që është në pronësi të shkollës dhe po planifikon të përfundojë spitalin e ri në terren deri në fund të 2016-ës. Përveç kësaj, shkolla po planifikon

hapjen e një fakulteti të ri për rehabilitimin e periferive të Prishtinës. Deri në fund të 2016-ës, ky fakultet i ri duhet të jetë hapur gjithashtu.

Organizimi dhe menaxhmenti:

Strukturat menaxheriale që shkolla ka bashkë ndarë me Kolegjin Iliria janë rindërtuar brenda organogramit të BPAL autonom Rezonanca, duke përfshirë (i) Bordin, (ii) Senatin dhe (iii) organizimin e Katedrave të ndryshme. Struktura është në përputhje me strukturat e institucioneve të ngjashme në Bashkimin Europian.

Stafi:

Janë ndërmarrë përpjekje të mëdha për zhvillimin e stafit. Megjithatë, shkolla duhet inkurajuar të përmirësojë në mënyrë konstante cilësinë e stafit duke shtuar persona të rinj dhe shumë të kualifikuar dhe duke përmirësuar kapacitetin e anëtarëve të stafit ekzistues. Kjo është një dëshirë e shprehur e stafit mësimor për të qenë në gjendje të zgjerojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre përkatëse duke pasur mundësi të kryejnë më shumë hulumtim brenda institucionit dhe përmes huazimeve në institucione të tjera jashtë Kosovës. Në mënyrë që të jetë më efiçente mbledhja e fondeve për hulumtim nga jashtë, stafi shpreh nevojën për një zyrë që i dedikohet ndihmës financiare për aplikimi dhe për administratën. Përveç kësaj, stafi shpreh dëshirën për të pasur një adresë e-maili të dhënë nga institucioni, duke qenë se ka një pikëpamje të përbashkët sipas të cilës një adresë institucionale do të rriste paraqitjen profesionale të anëtarëve të stafit jashtë institucionit. Menaxhmenti i shkollës duhet të ofrojë gjithashtu zyra të përshtatshme për stafin mësimor në mënyrë që të organizojë punën e tyre në lidhje me mësimdhënien, hulumtimin dhe administrimin dhe të ketë një vend të qetë ku të mund të takohet me studentët.

Studentët:

Studentët mirëpritën në mënyrë unanime Zbatimin e platformës Moodle, e cila përmirësoi qasjen sistematike në informacionin mbi kurset e studimit, materialet e studimit, provimet dhe për më tepër përmirësoi thelbësisht komunikimin mes studentëve dhe stafit akademik, si dhe sigurimin e cilësisë dhe cilësinë e plotë të procesit studimor. Përveç kësaj, studentët janë të kënaqur me proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies të ofruara nga institucioni, gjë për të cilën ata besojnë se atyre po u jepet një themel solid për jetën e tyre profesionale.

Struktura e re organizative e institucionit – sidomos struktura e re e Senatit dhe unionit të studentëve – u jep atyre mundësinë që të jenë aktivisht të përfshirë në proceset vendim-marrëse të organizimit. Studentët përmendën se megjithatë ata do të dëshironin më shumë ndërkombëtarizim (shih më poshtë), p.sh. programe shkëmbimi që i mundësojnë atyre të shpenzojnë një kohë të studimit jashtë vendit.

Ata do të mirëprisnin programin Erasmus në mënyrë që t'u mundësohej zhvillimi i studimeve të strukturuar në vende europiane. Përveç kësaj, studentët do të mirëprisnin më shumë lektorë të ftuar nga jashtë vendit.

Studentët përmendën se qasja në burimet e përshtatshme të informacionit duhet përmirësuar në mënyrë që të japë efekt në cilësinë e proceseve mësimore, në punimet individuale të studentëve (veçanërisht në tezën e diplomës) dhe do të mbështeste gjithashtu hulumtimin si për studentët, si për stafin akademik. Biblioteka duhet të porosisë në mënyrë të rregullt librat e botuar së fundi (botimet e reja) në të gjitha fushat e studimit. Për më tepër, institucioni duhet të ofrojë qasje në databazën e revistave shkencore relevante me qasje të plotë për të gjithë studentët dhe stafin akademik brenda dhe jashtë institucionit.

Financat:

Shkolla ka një plan financiar solid dhe EE mirëpret me entuziazëm faktin që institucioni ka caktuar 200K E për hulumtimin në programe të ndryshme master. Kontributi financiar do të rritet në 300 K E kur programi i Farmacisë dhe Stomatologjisë të jenë gati për tezën master.

Plani i zhvillimit:

Menaxhmenti i shkollës ka një vizion të qartë lidhur me planin e zhvillimit në nivelin e infrastrukturës për vitet e ardhshme. Plani i zhvillimit më imediat për kurrikulën është shumë i mirëpritur nga EE. Siç u sugjerua nga EE, duket se qeveria kosovare po instalon një provim kombëtar për zonat e ndryshme arsimore në sektorin e kujdesit shëndetësor. Shkolla duket se është e përfshirë në bisedimet respektive dhe është e përgatitur të instalojë një zyrë të re, e cila do të ndihmojë studentët që të përgatiten për provimet kombëtare.

Për më tepër, shkolla do të instalojë një zyrë që lehtëson vendosjet ndërkombëtare të studentëve dhe stafit.

Ndërkombëtarizimi:

Siç u përmend më sipër, shkolla do të instalojë një zyrë për lehtësimin e vendosjeve ndërkombëtare të studentëve dhe stafit. Për studentët, qasja në programin Erasmus, do të jetë kyç në mënyrë që t'u mundësojë atyre zhvillimin e studimeve për disa muaj në Zonën Europiane.

BPAL Rezonanca në Prishtinë aplikoi për akreditimin e programeve të mëposhtme:

1. Bachelor 'Infermieri'
2. Master në 'Infermieri'
3. Bachelor në 'Biokimisti Laboratorike'

4. Bachelor në 'Mjekësi Sanitare'
5. Bachelor 'Radiologji diagnostike'
6. Master në 'Radiologji Diagnostike'
7. Bachelor në 'Farmaci komunitare'
8. Master në 'Farmaci'
9. Bachelor në 'Fizioterapi'
10. Program i integruar (niveli 6 dhe 7) në Stomatologji

Për të gjitha katër programet:

Është për t'u vënë re se situatë e punësimit të të diplomuarve të Rezonancës duket shumë e mirë, duke nënvizuar cilësinë e ofruar nga mësimdhënia dhe institucioni. EE pranon nevojën për vazhdimin e programeve të lartpërmendura në mënyrë që të plotësohen nevojat lokale dhe të shmanget largimi i studentëve të rinj dhe premtues në vendet fqinje. Të gjitha programet janë tashmë të akredituara nën strukturën menaxheriale të kaluar dhe rrjedhimisht janë vlerësuar kryesisht çështjet institucionale (shih më sipër). EE pranon përpjekjen e ndërmarrë nga institucioni në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe infrastrukturës në Prishtinë, që nga akreditimi i fundit në vitin 2014. Një përmirësim madhor është zbatimi i suksesshëm i "Moodle" si platformë e mësimi elektronik.

Menaxhmenti thekson se kjo përpjekje madhore ka përmirësuar konsiderueshëm menaxhimin e cilësisë brenda institucionit dhe organizmin e provimit. Të dy palët, studentët dhe stafi mësimor janë entuziastë për instrumentin e ri në parim, megjithatë, stafi ka ende nevojë për mbështetje shtesë në mënyrë që të verë në përdorim të plotë instrumentin e ri. EE vlerëson përpjekjen e konsiderueshëm të shkollës për të përmirësuar kapacitetet e hulumtimit për programin master që është në zhvillim duke caktuar 200K euro ekskluzivisht për këto detyra. Duke marrë parasysh përpjekjen e konsiderueshme të ndërmarrë nga menaxhmenti për përmirësimin e infrastrukturës të shkollës, EE do të sugjeronte që numrin maksimal i studentëve të rritet me 30% atje ku menaxhmenti e sheh të nevojshme. Sipas kriterëve dhe procedurave për akreditim (Udhëzimi për Ekspertët (Programet Akademike)) dhe vlerësimin e mëposhtëm të të gjitha dosjeve/dokumenteve dhe informacionit të dhënë në kohën e vizitës në terren, EE sugjeron dhënien e akreditimit për kohën maksimale të parashikuar nga ligji për programet e ndryshme në Prishtinë.

Detajet jepen në seksionin e radhës:

Ad.1 Bachelor 'Infermieri'

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit. Programi është i organizuar dhe realizohet sipas standardeve europiane. Programi u vlerësua sipas 60 studentëve për vit që shkolla synon të ketë në programin bachelor në Prishtinë.

Janë ndërtuar laboratorë praktikë të rinj, që mundësojnë mësimin efektiv në grupe të vogla. Laboratorët janë të mirë-pajisur, megjithatë, kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

2. Stafi

Të paktën 50% e stafit mësimor për pjesën e infermierisë ka nevojë për një master në infermieri. Për momentin kjo kërkesë nuk është përmbushur, megjithatë, duke konsideruar numrin në rritje të studentëve që institucioni synon të ketë në vitet që vijnë, duhet treguar kujdes i veçantë në përmbushjen tërësore të kësaj kërkesë.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura në Prishtinë është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Stafi mësimor e përmendi se qendra e simulimit do të ishte e dobishme për përmirësimin e cilësisë së rezultateve mësimdhënëse dhe mësimnxënëse. Një çështje e ngritur gjatë akreditimit të fundit ishte literatura e vjetruar në bibliotekë dhe qasja i kufizuar në databazat online, relevante për infermierinë. Është shqetësuese që kjo çështje nuk u zgjidh në mënyrën e duhur. Literatura në bibliotekë është ende e vjetruar dhe qasja në databazën online relevante për infermierinë – pavarësisht se e pranishme për momentin për një kohëzgjatje të kufizuar – duket se nuk është e garantuar për të ardhmen. Të dy çështjet duhen zgjidhur sa më shpejt të jetë e mundur.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe program deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Është shumë pozitiv fakti që platformë e

mësimin elektronik, Moodle, është zbatuar, gjë që ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë mësimore.

Përfundim:

Rekomandim nga Ekipi i Ekspertëve:

Programi për bachelor në "Infermieri", nën udhëheqjen autonome të Rezonancës, mund të rekomandohet për akreditim për periudhën e parashikuar nga ligji për

Ad. 2 Master në 'Infermieri'

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit. Programi është i organizuar dhe realizohet sipas standardeve europiane. Programi u vlerësua sipas 50 studentëve për vit në programin master në Prishtinë.

Planet e hulumtimit për studimet master kanë nevojë të përpunohen në detaj.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

2. Stafi

Të paktën 50% e stafit për pjesën e infermierisë duhet të kenë PhD në infermieri. Për momentin kjo kërkesë nuk është përmbushur, megjithatë, duke konsideruar numrin në rritje të studentëve që institucioni synon të ketë në vitet që vijnë, duhet treguar kujdes i veçantë në përmbushjen tërësore të kësaj kërkesë.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura në Prishtinë është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Një çështje e ngritur gjatë akreditimit të fundit ishte literatura e vjetruar në bibliotekë dhe qasja i kufizuar në databazat online, relevante për infermierinë. Është shqetësuese që kjo çështje nuk u zgjidh në mënyrën e duhur. Literatura në bibliotekë është ende e vjetruar dhe qasja në databazën online relevante

për infermierinë – pavarësisht se e pranishme për momentin për një kohëzgjatje të kufizuar – duket se nuk është e garantuar për të ardhmen. Të dy çështjet duhen zgjidhur sa më shpejt të jetë e mundur.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe programi deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Është shumë pozitiv fakti që platforma e mësimit elektronik, Moodle, është zbatuar, gjë që ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë mësimore.

Përfundim:

Rekomandimi nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për master në “Infermieri”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën minimale të parashikuar nga ligji.

Ad. 3 Bachelor në ‘ Biokimisti Laboratorike’

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit. Programi është i organizuar dhe realizohet sipas standardeve europiane.

Programi u vlerësua sipas 60 studentëve që shkolla synon të ketë në vit në Prishtinë.

Janë ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin dhe rritjen thelbësore të pajisjeve për punë praktike në laborator, duke mundur të kësaj një mjedis të përshtatshëm mësimor.

Planet e hulumtimit për studimet master duhet të përpunohen në detaj.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

2. Stafi

Stafi mësimor për programin duhet të ketë një master ose PhD në këtë disiplinë. Për momentin kjo kërkesë është thuhet e plotësuar, Megjithatë, menaxhmenti paraqet një “program zhvillimi” që tregon përmirësimin e kësaj çështjeje në vitet e ardhshme.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë programe shkëmbimi ndërkombëtare për stafin dhe studentët sa më shpejt të jetë e mundur!

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura në Prishtinë është e përshtatshme për zhvillimin e një programi për 50 studentë. Megjithatë, laboratori ka nevojë për përmirësim konstant në mënyrë që të mundësojë mësimdhënie të përshtatshme.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe programi deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, institucioni ka implementuar Sistemin Moodle si një platformë për mësimin elektronik dhe e përdor këtë platformë për provimet dhe për kontrollin e cilësisë.

Përfundim:

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për bachelor në “Biokimisti Laboratorike”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës, mund të rekomandohet për akreditim për periudhën minimale të parashikuar nga ligji .

Ad. 4 Bachelor në ‘Radiologji Diagnostike’

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit dhe parimet e tij operuese. Programi është organizuar dhe zhvillohet sipas standardeve europiane. Për më tepër, metodat mësimore dhe përmbajtja e njësive mësimore janë të mjaftueshme për arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe rezultateve të programit.

Programet janë vlerësuar sipas 40 studentëve në vit që shkolla synon të ketë për këtë program.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin është i përshtatshëm për përmbushjen e nevojave të tij.

3. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Është çmuar fakti që institucioni ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në pajisjet e reja të imazhit, që renditen në krye të vendeve të rajonit..

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe programi deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, institucioni ka implementuar Sistemin Moodle si një platformë për mësimin elektronik dhe e përdor këtë platformë për provimet dhe për kontrollin e cilësisë.

Përfundim:

Rekomandim nga Panel ii Ekspertëve:

Programi për bachelorin në “Radiologji Diagnostike”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën maksimale të parashikuar me ligj.

Ad. 5 Master në ‘Radiologji Diagnostike’

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit dhe me parimet operuese. Programi është organizuar dhe zhvillohet sipas standardeve europiane. Për më tepër, metodat mësimore dhe përmbajtja e njësive mësimore janë të mjaftueshme për arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe rezultateve të programit.

Programet u vlerësuan sipas 40 studentëve që shkolla synonte këtë në vit për këtë program.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin është i përshtatshëm për të përmbushur nevojat e programit.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Është çmuar fakti që institucioni ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në pajisjet e reja të imazhit, që renditen në krye të vendeve të rajonit.

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe programi deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, institucioni ka implementuar Sistemin Moodle si një platformë për mësimin elektronik dhe e përdor këtë platformë për provimet dhe për kontrollin e cilësisë.

Përfundim:

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për masterin në “Radiologji Diagnostike”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës, mund të rekomandohet për akreditim për periudhën maksimale të parashikuar nga ligji nga ana kosovare.

Ad. 6 Bachelor në ‘Mjekësi sanitare’

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit dhe me parimet operuese. Programi është organizuar dhe zhvillohet sipas standardeve europiane. Për më tepër, metodat mësimore dhe përmbajtja e njësive mësimore janë të mjaftueshme për arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe rezultateve të programit. Sipas mësuesve të kursit, program është i suksesshëm dhe përmbush nevojat në

rajon, pavarësisht faktit se ai është dukshëm i vetmi program në mjekësi sanitare në Kosovë.

Programet janë vlerësuar sipas 40 studentëve që shkolla synon të ketë në vit për këtë program.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin është i përshtatshëm për të përmbushur nevojat e programit.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e programit.

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe programi deri më tash është vlerësuar sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, institucioni ka implementuar Sistemin Moodle si një platformë për mësimin elektronik dhe e përdor këtë platformë për provimet dhe për kontrollin e cilësisë.

Përfundim për Degën në Prishtinë:

Rekomandimi nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për bachelorin në "Mjekësi sanitare", nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën maksimale të parashikuar nga ligji i anës kosovare.

Ad. 7 Bachelor në 'Farmaci komunitare'

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programet akademike korrespondojnë me parimin udhëheqës të institucionit. Programet janë organizuar dhe do të zhvillohen sipas standardeve europiane. Programi është vlerësuar sipas 50 studentëve që shkolla synon të ketë në vit nga ana e Prishtinës.

Për arsye historike, programet në Farmaci janë ndarë në bachelor dhe master në mënyrë që të mundësojnë rritjen hap pas hapi të institucionit në njohuri, infrastrukturë dhe kapacitet, megjithatë, do të ishte e këshillueshëm për të ardhmen që të ofrohej një program farmacie si program i integruar (niveli 6 dhe 7) në Farmaci.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin duhet të ketë master në disiplinat respektive. Ky qëllim është thujtse i arritur. Megjithatë, menaxhmenti paraqiti një "program zhvillimi" që tregon përmirësimin e kësaj çështjeje në vitet e ardhshme. Sipas zhvillimit që përjetoi EE deri më tash, EE ka besim në zhvillimin e suksesshëm në të ardhmen.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë programet e shkëmbimit ndërkombëtar për stafin dhe studentët!

4. Financa dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshëm për zhvillimin e programit. Dy personat përgjegjës për laboratorin për teknologjinë farmaceutike paraqitën me krenari pajisjet e reja të siguruara nga institucioni, megjithatë, përmendën gjithashtu se ka nevojë për përpjekje shtesë në mënyrë që të përmirësohet më tej situata e laboratorit. Institucioni mund të demonstrojë se planet përkatëse janë të pranishme dhe do të përmbushen në të ardhmen e afërt.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe program është vlerësuar deri më tash sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Duhet zhvilluar kurse për përmirësimin e vazhdueshëm të anëtarëve të stafit. Është shumë pozitiv fakti që së fundmi është implementuar platforma e mësimit elektronik, Moodle, e cila ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies.

Përfundim:

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për bachelorin në "Farmaci komunitare", nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën e parashikuar me ligj nga ana kosovare.

Ad. 8 Master në 'Farmaci'

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programet akademike korrespondojnë me parimin udhëheqës të institucionit. Programet janë organizuar dhe do të zhvillohen sipas standardeve europiane. Programi është vlerësuar sipas 50 studentëve që shkolla synon të ketë në vit nga ana e Prishtinës.

Për arsye historike, programet në Farmaci janë ndarë në bachelor dhe master në mënyrë që të mundësojnë rritjen hap pas hapi të institucionit në njohuri, infrastrukturë dhe kapacitet, megjithatë, do të ishte e këshillueshëm për të ardhmen që të ofrohej një program farmacie si program i integruar (niveli 6 dhe 7) në Farmaci.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin duhet të ketë PhD në disipinat respektive. Ky qëllim është thujse i arritur. Megjithatë, menaxhmenti paraqiti një "program zhvillimi" që tregon përmirësimin e kësaj çështjeje në vitet e ardhshme. Sipas zhvillimit që përjetoi EE deri më tash, EE ka besim në zhvillimin e suksesshëm në të ardhmen.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë programet e shkëmbimit ndërkombëtar për stafin dhe studentët!

4. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshëm për zhvillimin e programit. Dy personat përgjegjës për laboratorin për teknologjinë farmaceutike paraqitën me krenari pajisjet e reja të siguruar nga institucioni, megjithatë, përmendën gjithashtu se ka nevojë për përpjekje shtesë në mënyrë që të përmirësohet më tej situata e laboratorit. Institucioni mund të demonstrojë se planet përkatëse janë të pranishme dhe do të përmbushen në të ardhmen e afërt.

Gjatë ri-akreditimit kjo çështje duhet kontrolluar!

5. Menaxhimi i Cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe program është vlerësuar deri më tash sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Duhet zhvilluar kurse për përmirësimin e vazhdueshëm të anëtarëve të stafit. Është shumë pozitiv fakti që së fundmi është implementuar platforma e mësimit elektronik, Moodle, e cila ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies.

Përfundim:

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për masterin në “Farmaci”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën minimale të parashikuar me ligj nga ana kosovare.

Ad. 9 Bachelor në ‘Fizioterapi’

1. Programi akademik dhe Menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit. Programi është organizuar dhe zhvillohet sipas standardeve europiane. Programi është vlerësuar sipas 40 studentëve që shkolla synon të ketë në vit në Prishtinë.

Nga diskutimet me përfaqësuesit e shkollës, EE mësoi se sektori i fizioterapisë në Kosovë po shkon drejt mbingopjes dhe për të ardhmen duhet të mbulohen vetëm nevojat e qarkullimit normal, megjithatë, do të kishte nevojë për programe të specializuara të masterit, për të cilat Rezonanca nuk po aplikon për momentin.

2. Stafi

Stafi mësimor për programin mund të përmbushë kërkesat.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë programe të shkëmbimit ndërkombëtar për stafin dhe studentët!

4. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Aktualisht, kabineti për fizioterapinë nuk është i pajisur në mënyrë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për praktikën e studentëve.

Pavarësisht se janë siguruar pajisje të reja, mësuesit e përfshirë në kurset e fizioterapisë shohin nevojën për më shumë tavolina dhe më shumë pajisje për laboratorin e biomekanikës, gjë që duhet siguruar së shpejti.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhen kontrolluar!

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe program është vlerësuar deri më tash sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Duhet zhvilluar kurse për përmirësimin e vazhdueshëm të anëtarëve të stafit. Është shumë pozitiv fakti që së fundmi është

implementuar platforma e mësimit elektronik, Moodle, e cila ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies.

Përfundim:

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi për bachelorin në “Fizioterapi”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën minimale një vjeçare të parashikuar me ligjin kosovar.

Ad. 10 Studime të integruara (niveli 6 dhe 7) në ‘Stomatologji’

1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi akademik korrespondon me parimin udhëheqës të institucionit. Programi është organizuar dhe zhvillohet sipas standardeve europiane. Programi është vlerësuar sipas 40 studentëve që shkolla synon të ketë në vit në Prishtinë.

2. Stafi

Stafi mësimor për programet duhet të jetë master ose doktor në këtë disiplinë. Për momentin, kjo kërkesë nuk është përmbushur plotësisht. Megjithatë, menaxhmenti paraqiti një “program zhvillimi” që tregon përmirësimin e kësaj çështjeje në vitet e ardhshme dhe e shkuara e afërt tregon se përmirësimet respektive do të materializohen.

Gjatë ri-akreditimit këto çështje duhet të kontrollohen!

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shkolla këshillohet të aktivizojë më shumë programe të shkëmbimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur! Kjo është një dëshirë e shprehur nga studentët, gjithashtu.

4. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësira dhe Pajisjet

Është caktuar një buxhet dhe infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e programit. Megjithatë, literature duhet përditësuar duke qenë se në shumë lëndë që ndryshojnë me shpejtësi si ganatologjia, keirologjia etj., edhe librat e sugjeruar në gjuhën angleze janë të vjetër më shumë se 15 vjet.

Fondet shtesë të dhëna nga menaxhmenti për të gjitha studimet në nivel master (200K euro, shih më sipër) do të ndihmojnë thelbësisht për të mundur një cilësi të respektueshme për tezat përkatëse për të cilat kanë nevojë projektet.

5. Menaxhimi i cilësisë

Është caktuar një plan për menaxhimin e cilësisë dhe program është vlerësuar deri më tash sipas tij. EE pranon përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Duhet zhvilluar kurse për përmirësimin e vazhdueshëm të anëtarëve të stafit. Është shumë pozitiv fakti që së fundmi është implementuar platforma e mësimit elektronik, Moodle, e cila ndihmon në rritjen e mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies.

Përfundim

Rekomandim nga Paneli i Ekspertëve:

Programi i integruar (niveli 6 dhe 7) në “Stomatologji”, nën udhëheqjen autonome të Rezonancës mund të rekomandohet për akreditim për periudhën minimale të parashikuar me ligj nga ana kosovare.